

# Rregullat e “KOSOVA MAKERS LEAGUE”

## **PJESËMARRJA**

Në Ligën “Kosova Makers” të cilën e organizon Fondacioni BONEVET mund të marrin pjesë fëmijët e arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët, të ndarë në dy grupmosha. Grupmosha e parë përfshinë fëmijët të cilët gjatë organizimit të Ligës janë nxënës nga klasa e parë deri në klasën e pestë, ndërsa grupmosha e dytë përfshinë nxënësit nga klasa e pestë deri në klasën e nëntë. Pasi që klasa e pestë përfshihet në të dy grupmoshat, nga kjo nënkuptohet se nxënësit nga klasa e pestë kanë të drejtë të zgjedhin grupmoshën me të cilën dëshirojnë të futen në garë. Gjithashtu, është e mundshme që garuesit e grupmoshës më të re të futen në grupmoshën e më të rriturve, vetëm nëse mësimdhënësi ose mentori vlerëson që garuesi i caktuar është i përgatitur për të garuar në grupmoshën e më të rriturve.

Pjesëmarrja në Ligë i'u mundësohet të gjitha institucioneve shkollore (publike dhe private) dhe qendrave të cilat punojnë me nxënës të klasave 1-9.

Pas aplikimit për pjesëmarrje në programin e Ligës, aplikantët e përzgjedhur do të pranojnë përmes adresës elektronike (e-mail) një letër konfirmimi të pjesëmarrjes në Ligë. Bordi i Ligës bën përzgjedhjen e aplikantëve të cilët do të marrin pjesë në Ligë. Mentorët e ekipeve garuese do të marrin robotët mBot disa javë para fillimit të garës, cilët gjithashtu do të jenë përgjegjës për robotët deri në fund të Ligës.

Në Ligë mund të marrin pjesë edhe tjera institucione shkollore publike dhe private të cilat nuk kanë aplikuar në ftesën e hapur për pjesëmarrje në Ligë ose pas aplikimit nuk janë përzgjedhur për ndarje të robotëve mBot, vetëm nëse me anë të mjeteve vetanake ose përmes donacioneve sigurojnë robotin mBot. Kërkesa për pjesëmarrje në Ligë duhet të bëhet jo më vonë se 15 ditë para fillimit të raundit të parë të Ligës në vitin shkollor.

Lista e plotë e të gjitha institucioneve që do të marrin pjesë në Ligë në vitin shkollor të caktuar do të jetë e publikuar në webfaqen e “Kosova Makers”, [www.kosovamakers.net](http://www.kosovamakers.net), jo më vonë se 20 ditë para fillimit të raundit të parë të Ligës.

## **KOMUNIKIMI ME PJESËMARRËSIT GJATË LIGËS**

Pas publikimit të listës së pjesëmarrësve, institucionet e përzgjedhura që marrin pjesë në Ligë do të pranojnë përmes adresës elektronike (e-mail) informatat mbi planin e mbajtjes së Ligës. Informata shtesë lidhur me mbajtjen e garës, rregullat, detyrat dhe udhëzimet e pjesëmarrësve dhe koordinatorëve të raundeve lokale të garave do të publikohen në faqen zyrtare të Ligës. Njoftimet të cilat do të jenë të rëndësishme do t'u dërgohen të gjithë pjesëmarrësve përmes adresës elektronike (e-mail).

## **ORGANIZIMI I GARAVE**

Liga është e ndarë në raunde, të cilat do të mbahen gjatë vitit shkollor. Gjatë një viti do të mbahen gjithësej 5 raunde garuese. Orari i përgjithshëm i raundeve garuese do të jetë në dispozicion në webfaqen e Ligës

disa javë para fillimit të raundit të parë. Pjesëmarrësit do të jenë të ndarë në grupe sipas lokacionit gjeografik - rajoneve. Lista e rajoneve dhe pjesëmarrësve për rajonin e caktuar do të jetë në dispozicion në webfaqen e Ligës në formë tekstuale dhe hartografike, minimum 15 ditë para raundit të parë garues. Gjatë mbajtjes së garës të gjithë pjesëmarrësit e rajonit të caktuar mblidhen në njërin nga qendrat e BONEVET Prishtina apo BONEVET Gjakova, dhe mbajnë garën në të njejtën kohë. Lista e qendrave për mbajtjen e garës dhe detajet kontaktuese të qendrave dhe personave përgjegjës për koordinimin e mbajtjes së garave në qendër, do të jetë në dispozicion në webfaqen e Ligës ose do t'i dërgohen pjesëmarrësve përmes adresës elektronike (e-mail) minimum një javë para raundit të Ligës.

## **TË GJITHË GARUESIT DUHET TË KENË MIRATIMIN E PRINDIT OSE KUJDESTARIT PËR PJESËMARRJE NË LIGË**

Të gjitha institucionet pjesëmarrëse në Ligë obligohen që të grumbullojnë miratimet e prindërve për të gjithë fëmijët që potencialisht do t'i kycin në Ligë gjatë vitit shkollor dhe t'i dërgojnë miratimet origjinale të nënshkruara përmes postës në adresë të organizatorit më së voni 7 ditë para fillimit të raundit të parë garues të vitit shkollor përkatës. Miratimet e prindërve pranohen vetëm në formën e përshkruar, ku shembulli i miratimit është i publikuar në webfaqen e Kosova Makers League [www.kosovamakers.net](http://www.kosovamakers.net) dhe do t'i dërgohet të gjithë institucioneve të kyçura përmes adresës elektronike (e-mail).

## **PAJISJET DHE MATERIALI PËR MBAJTJEN E GARËS**

Paisjet dhe materiali për mbajtjen e garës janë të definuara nga ana e organizatorit dhe janë të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit. Gjatë garës, garuesve ju lejohet të garojnë vetëm me paisjet e përshkruara nga ana e organizatorit. Lista e paisjeve të zgjedhura për mbajtjen e garës do të jetë në dispozicion në webfaqen e Ligës, dhe lista e paisjeve të nevojshme për raundin e caktuar do të jetë në dispozicion minimum tre ditë para mbajtjes së raundit garues. Gjithashtu, të dy grupmoshat e garuesve shfrytëzojnë paisjet e njëjta.

## **DETYRAT E GARËS**

Detyrat e garave do u'a dorëzohet pjesëmarrësve përmes adresës elektronike (e-mail). Gjatë mbajtjes së raundit, detyrat dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm për mbajtjen e raundit do t'i dorëzohen koordinatorit të qendrës në të cilën mbahet raundi.

## **UDHËZIMET PËR MBAJTJEN E GARËS**

### **Raundet e garës**

Çdo shkollë apo institucion pjesëmarrës në raundin e garës paraqet më së shumti një ekip të grupmoshës së të rinjëve dhe një ekip të grupmoshës së të rriturve. Çdo ekip përbëhet nga 4 nxënës dhe një mentor/përfaqësues të institucionit. Ekipi mund të përbëhet edhe nga më pak se 4 nxënës nëse shkolla apo institucioni pjesëmarrës nuk ka mjaftueshëm garues për raundin e caktuar. Pjesëmarrësit janë të obliguar të paraqesin minimum një ekip në garë. Pjesëmarrësit mund të përgatisin për garë edhe më shumë se katër nxënës sipas grupmoshës, mirëpo në garë nuk lejohet të formojnë ekipën me më shumë se katër nxënës. Përzgjedhja e nxënësve të cilët do të marrin pjesë në raundet e garës bëhet nga vetë mentorët. Para mbajtjes së raundeve organizatori do të kërkojë nga mentorët paraqitjen e emrave të 4 nxënësve që do të marrin pjesë në raundin garues. Emrat e garuesve i paraqesin mentorët e garave përmes formularit online të cilin e vë në dispozicion organizatori. Pjesëmarrësit që nuk paraqesin emrat e

garuesve deri në afatin e definuar nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në atë raund të garave. Në rast të mungesës të ndonjë nxënësi, pjesëmarrësi mund të marrë pjesë në raundin garues me numër më të vogël të nxënësve në ekip. Mënyra e dorëzimit të rezultateve dhe e paraqitjes së ekipit në raundin garues do të jetë e definuar në webfaqen e organizatorit dhe do i dërgohet pjesëmarrësve përmes adresës elektronike (e-mail).

Sa i përket mbajtjes së raundit të garës të gjithë pjesëmarrësit mblidhen në BONEVET Prishtina ose BONEVET Gjakova varësisht nga regjioni i shkollës . Raundi garues mbahet gjatë ditëve të punës, në orët e pasditës dhe zgjatë rreth tre orë. Të gjitha materialet e dhëna me përjashtim të listës së pjesëmarrësve konsiderohen të fshehta deri në fillim të garës.

Gjatë garës do të formohen disa komisione vlerësuese me nga dy mentorë. Mentorët e komisioneve vlerësuese nuk do të kenë mundësi të vlerësojnë shkollën e tyre. Listën e komisioneve vlerësuese dhe të pjesëmarrësve përkatës që ato vlerësojnë e paraqet organizatori. Të gjitha komisionet vlerësuese pranojnë nga dy kopje të detyrave për mbajtjen e garës, dy kopje të udhëzimeve për vlerësimin e detyrave dhe mënyrën e punës së komisionit vlerësues, dhe dy kopje të tabelave për vlerësimin e garuesve.

Detyrat për mbajtjen e garës dhe tabelat e vlerësimit mbesin mbi tavolinat e garuesve përgjatë tërë kohëzgjatjes së garës. Gjatë garës, në përfundim të fazave të caktuara të garës të cilat vlerësohen, komisioni vlerësues i shkruan secilit ekip garues pikët e fituara në tabelën e vet të vlerësimit. Komisioni vlerësues i njofton ekipin garues për numrin e pikëve të fituara. Në përfundim të garës, mentorët vijnë te ekipet e tyre dhe i kontrollojnë rezultatet së bashku me ta. Në rast ankese për numrin e pikëve të dhëna, ekipi garues, mentorët dhe komisioni vlerësues duhet të zgjidhin ankesën brenda afatit prej 15 minutash nga përfundimi i punës. Në përfundim të garës dhe kohës për ankese, komisionet vlerësuese grumbullojnë tabelat e plotësuara të vlerësimit të garuesve dhe i'a dorëzojnë organizatorit për rishqyrtim të pikëve.

Organizatori do të përpilojë rang listat e përgjithshme sipas pikëve në bazë të rajoneve dhe për tërë Kosovën. Në 24 orët e para të publikimit, rezultatet do të jenë preliminare. Nëse ndonjë ekip garues paraqet ankese në lidhje me rezultatet, pjesëmarrësit duhet të njëjtën ta paraqesin përmes adresës

elektronike (e-mail) përgjatë 24 orëve pas së cilës kohë do të shpallen rezultatet përfundimtare në të cilat më nuk ekziston mundësia për ankesë.

### **Vlerësimi i pjesëmarrësve në gara**

Nëse raundi është individual, çdo nxënës vlerësohet individualisht. Përveç kësaj, rezultatet e të gjithë nxënësve të një ekipe në raundin garues mblidhen dhe formojnë rezultatin total të ekipit.

Nëse raundi është ekipor atëherë nuk ka vlerësim individual të nxënësve, vetëm vlerësohet zgjidhja e ekipit pavarësisht nga numri i anëtarëve. Pikët i përshkruhen vetëm shkollës apo institucionit, ndërsa nxënësit në raundin ekipor nuk fitojnë pikë individuale.

Renditja sipas rezultateve të fituara në raundet garuese do të kryhet individualisht për secilin garues si dhe pjesëmarrës në dy rajonet ku mbahet gara.

Rezultatet e të gjithë pjesëmarrësve sipas grupmohave, nga çdo raund barten në nivel kombëtar dhe renditen. Nuk ekziston ndonjë numër minimal i pikëve të cilat duhet mbledhur në raundin paraprak në mënyrë që pjesëmarrësi të kualifikohet në raundin vijues.

Në fund të vitit shkollor mblidhen rezultatet e pjesëmarrësve dhe shpallet rang lista e pjesëmarrësve më të suksesshëm sipas rajonit dhe grupmohës. Rezultatet individuale të nxënësve nuk mblidhen.